REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-IV-14-4598

Ankuesi

A. T K, Prishtinë

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga "Agim Ramadani", nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me 11 dhjetor 2019, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.

II. Vërtetohet vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit-Autoritetit të Likuidimit PEJ194-0005, i datës 04 qershor 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

III. Secila palë i bart shpenzimet e veta.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 16 qershor 2014, A. T K parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (në tekstin e mëtejmë: AL) nr. PEJ194-0005, i datës 04 qershor 2014. Në vendimin e kundërshtuar, kërkesa e ankuesit për pagesën e Tatimit në burim, në shumë prej 13,511.62 €, për NSH, në likuidim, është aprovuar pjesërisht për shumën prej 5,706.73 €, në pajtim me nenin 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tej Shtojca e Ligjit të AKP-së), ndërsa është refuzuar për shumën prej

7.804.89 €, si e pabazuar. Ankuesi pohoi se AL e ka trajtuar si kategori të njëjtë tatimore ndëshkimet dhe interesin që për ankuesin është e pa pranueshme, pasi që është në kundërshtim me nenin 3 dhe 5 të Rregullores nr. 2000/20 mbi Administratën dhe procedurat tatimore, nenin 12.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 1/2000 Organizimi dhe Procedurat e Administratës Tatimore, neni 22 të Ligjit 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat si dhe nenin 28 te Ligjit Nr 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Ankuesi ka propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, ta anulohet vendimi i atakuar dhe ta detyroj AKP-në që të paguaj të gjitha obligimet tatimore të subjektit NSH .

Me 03 dhjetor 2019, e paditura A. K P parashtroi mbrojtje në ankesë, në të cilën ka pohuar se vendimi i AL-së është i bazuar në ligj dhe i drejtë dhe se janë të pa qëndrueshme pretendimet e paditësit se AL gjatë shqyrtimit të kërkesës kreditore do të duhej të merrte për bazë dhe të aplikojë ligjin e ATK-së dhe jo ligjin e AKP-së. Po ashtu AKP-ja ka pohuar se neni 37.3 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së parasheh që "të gjitha kërkesat e bëra ndaj ndërmarrjes mund të përfshijnë interes mbi secilën shumë themelore që është grumbulluar para datës së vendimit të Likuidimit, me kusht që ky interes të mos tejkaloj 10 % të shumës themelore". Sipas AKP-së, në bazë të nenit 37.3 të shtojcës se ligjit të AKP-së, vetëm një shumë prej 10% është e pagueshme përmbi shumën themelore që NSH ka detyrim (qoftë interes, ndëshkim etj.). Andaj ka propozuar që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PEJ194-0005, i datës 04 qershor 2014.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligjit për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Në vendimin e kundërshtuar, AKP-ja arsyetoi se sipas nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, kërkesa mund të përfshijë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës së kërkesës themelore. Bazuar në analizën e të paditurës dhënë në vendimin e kundërshtuar, shuma e pretenduar nga ankuesi në emër të tatimit në burim ishte 13,511.62€, nga e cila, shuma prej 5,187.94 € ishte shuma themelore, kurse shuma e ndëshkimeve ishte 8,323.68€. Në këtë mënyrë shuma totale e aprovuar në emër të Tatimit në burim ishte shuma themelore prej 5,187.94€, duke shtuar shumën prej 518.79 € (10 % ndëshkimet dhe interesi i akumuluar të shumës themelore), apo gjithsej 5,706.73 €.

Sipas nenit 37.3 të shtojcës së ligjit të AKP-së të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore".

Gjykata konstaton se kjo dispozitë ligjore mbizotëron mbi dispozitat e legjislacionit fiskal të parashtruara nga ankuesi. Procesi ligjor i likuidimit të NSH-ve është një procedurë kolektive ku ligjvënësi ka siguruar që ekziston mundësia që kreditorëve të renditur më ulët në renditjen e përparësisë së pagesave, t'ju paguhet diçka. Neni 37.3 ka rëndësi të madhe për këtë sepse përndryshe do të jetë edhe më e mundshme që të ardhurat nga asetet e likuiduara do të shfrytëzohen nga kërkesat me renditje më të lartë, sipas nenit 40, të cilat do të bëhen më të mëdha përmes akumulimit të kamatës mbi shumën themelore. Neni 37.3 parandalon këtë dhe kufizon shumën e kamatës në 10% të shumës themelore të kërkesës kreditore. Ai vepron me vetëm dy kategori ligjore, e para është shuma themelore e kërkesës kreditore dhe e dyta është kamata për shumën themelore të saj. Atë të cilën ankuesi po përpiqet të bëjë, se ndëshkimet dhe kamata janë dy kategori të ndara dhe të definuara si të tilla në legjislacionin fiskal, nuk është e vlefshme për këtë procedurë, sepse edhe dënimet llogariten lidhur me shumën themelore të kërkesës kreditore, pikërisht si kamata fiskale dhe për shkak të kësaj, ato bien në të njëjtën kategori të dytë të parashikuar nga neni 37.3, të kufizuara në 10 % të shumës themelore.

Kërkesa e tanishme e kreditorit është bërë në procedurat e likuidimit, të rregulluar me shtojcën e Ligjit të AKP-së, dhe rrjedhimisht, ky ligj mbizotëron mbi çdo dispozitë të Ligjit të Kosovës që nuk është në përputhje me të (neni 31.1). Një zgjidhje tjetër në lidhje me kreditorin fiskal, bazuar në cilësinë e ATK-së si autoriteti i vetëm i autorizuar për mbledhjen e tatimeve në Republikën e Kosovës, do të përbënte diskriminim në mesin e kreditorëve tjerë.

Andaj në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksa gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 8.2 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi lirohet nga pagesa e taksave gjyqësore.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj
Gjyqtar